



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2023:129634

Datë: 22.03.2024

Numri i dokumentit: 05491968

PKR.nr.372/23

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA, kryetari i trupit gjykues-gjyqtari Alban Ajvazi, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Leutrim Hoti, në çështjen penale ndaj të pandehurve: E.H.1 dhe E.H.2 për shkak të veprës penale në bashkëkryerje Falsifikimi i parasë nga neni 296 par.2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, si dhe L.U për shkak veprës penale ndihmë në kryerjen e veprës penale Falsifikimi i parasë nga neni 296 par.2 lidhur me nenin 33 të KPRK-së, të akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë/Departamenti i Krimeve të Rënda me marrëveshje për pranimin e fajësisë PP.I.nr.29/2023 të datës 09.10.2023, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me datë 18.03.2024, në prezencë të palëve në procedurë, me datën 20.03.2024 mori dhe shpalli publikisht, ndërsa me datë 22.03.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

Të pandehurit:

I. E.H.2, nga i ati H. dhe nëna M., e vajzërisë Q., i lindur me ... në fshatin ..., me vendbanim në fshatin ..., Komuna Vushtrris, i martuar, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së dobët ekonomike, me numër personal ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, ka qenë në masën e paraburgimit nga data nga 07.06.2023 deri me 06.07.2023.

II. L.U nga i ati S. dhe nëna B., e vajzërisë I., i lindur më datë ..., në Prishtinë, me vendbanim në fshatin ..., Komuna e Vushtrrisë, ka të kryer shkollën e mesme, i pa martuar, i gjendjes së dobët ekonomike, me numër personal ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, ka qenë nën masën e arrestit shtëpiak nga data 07.06.2023 deri me datën 06.07.2023

JANË FAJTOR

I

Sepse:

I pandehuri E.H.2 nga data e pa verifikuar me qellim të përfitimit personal dhe me qellim për t'i vënë në qarkullim si të vërteta, posedojnë paratë të falsifikuara, çka edhe është vërtetuar me datë 07.06.2023 rreth orës 18:25 kur në fshatin Banjska në rrugën magjistrale Vushtrri-Mitrovicë, policia ka ndaluar veturën-kombi i markës "Mercedes Vito" ngjyrë të bardhë me targat e regjistrimit ... në të cilën kanë qenë të tre të pandehurit E.H.1, E.H.2 dhe L.U, ku gjatë kontrollit të veturës është gjetur një kuti në të cilën kanë qenë të mbështjella 4296 copa të monedhave të metalit të vlerës prej nga 2 euro të vlerës së përgjithshme 8592 euro për të cilat dyshohen se janë

të falsifikuara çka është vërtetuar që janë plotësisht të falsifikuara në bazë të Raportit të Agjencisë së Kosovës për Forenzikë numri AKF/2023-1827/2023-1691, datë 15.08.2023,-

- Me këtë ka kryer veprën penale në bashkëkryerje Falsifikimi i parasë nga neni 296 par.2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

II

I pandehuri L.U në ditën, kohen dhe në vendin si në dispozitivin I të aktakuzës të pandehurve E. dhe E.H.2, i ka ndihmuar në kryerjen e veprës penale duke ju ofruar mbështetje logjistike në atë mënyre kur me veturën - kombi i markës "Mercedes Vito" ngjyrë të bardhë me targat e regjistrimit ... ka dërguar nga fshati ... deri te fshati Banjska, në rrugën magjistrale Vushtrri-Mitrovicë,-

- Me këtë ka kryer veprën penale ndihmë në kryerjen e veprës penale Falsifikimi i parasë nga neni 296 par.2 lidhur me nenin 33 të KPRK-së.

Andaj, gjykata konform neneve 7, 17, 21, 31, 33, 38, 40, 42, 43, 44, 69, 70, 71, 72, 79 të KPRK-së, si dhe neneve 230 dhe 364 të KPPRK-së, të pandehurit i:

G J Y K O N

I. Të pandehurit E.H.2, i shqipton dënim me **BURGIM** efektiv në kohëzgjatje prej **1 (një) vit, e 4 (katër) muaj**, i cili dënim do të ekzekutohet në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Në pajtim me nenin 79 të KPRK-së koha e kaluar në paraburgim nga data 07.06.2023 e deri më datën 06.07.2023, do ti llogaritet në dënimin e shqiptuar me burgim.

II. Të pandehurit L.U, i shqipton dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6 muaj, i cili dënim me pëlqimin e tij, zëvendësohet në dënim me **GJOBË** prej **3,000 (tremijë) euro** në pajtim me nenin 44 të KPRK-së, të cilin dënim me gjobë obligohet ta paguaj në afat prej 15 nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Në pajtim me nenin 79 të KPRK-së koha e kaluar në arrest shtëpiak nga data 07.06.2023 e deri më datën 06.07.2023, do ti llogaritet në dënimin e shqiptuar.

Nëse dënimi i shqiptuar në të holla nuk mund të ekzekutohet, gjykata dënimin me gjobë në bazë të nenit 43 par.3, të KPRK-së, do ta zëvendësoj me dënim me burg, ku një (1) ditë burgim do të llogaritet me 20 (njëzet) euro gjobë.

Të akuzuarit E.H.2 dhe L.U, obligohen secili veç e veç, që t'i paguajnë të gjitha shpenzimet e procedurës penale, në emër të paushallit gjyqësor shumë prej njëqind (100) euro, kurse në emër të kompensimit të viktimave të krimit shumë prej pesëdhjetë (50) euro.

URDHËR - URDHËROHET konfiskimi i përhershëm i 4296 copë monedhave prej 2 euro në vlerë prej 8592 euro, të cekura si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, këto monedha duhet të shkatërrohen nga Policia e Kosovës, në bashkëpunimin me Prokurorinë Themelore në Prishtinë.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë/Departamenti i Krimeve të Rënda, në këtë gjykatë, ka paraqitur aktakuzë me marrëveshje për pranimin e fajësisë PP.I.nr.29/2023 të datës 09.10.2023

kundër të pandehurve: E.H.1 dhe E.H.2 për shkak të veprës penale në bashkëkryerje Falsifikimi i parasë nga neni 296 par.2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, si dhe L.U për shkak veprës penale ndihmë në kryerjen e veprës penale Falsifikimi i parasë nga neni 296 par.2 lidhur me nenin 33 të KPRK-së.

Gjykata ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit të marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë me datën 18.03.2024, në të cilën i pandehuri E.H.1 nuk ka qëndruar pranë marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë, gjykata me aktvendim e ka anuluar marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë dhe me aktvendimin nën shenjën PKR.nr.372/23 të datës 18.03.2024, e ka veçuar procedurën penale për të njëjtin dhe ka vazhduar rrjedhën e procedurës penale vetëm në raport me të pandehurit E.H.2 dhe L.U të cilët deklaruan se e pranojnë fajësinë dhe qëndrojnë pranë marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë të arritur në prokurori për veprat penale që i vihen në barrë.

Deklarimi i palëve në seancën e shqyrtimit të marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë dhe dënimin e propozuar:

Prokurorja e shtetit Javorka Prilencevic ka deklaruar se: marrëveshja për pranimin e fajësisë nga të pandehurit E.H.2 dhe L.U është lidhur me vullnetin e tyre pa asnjë imponim dhe në prezencë të mbrojtësve të tyre. Për të pandehurin E.H.2 është arritur marrëveshja të që t'i shqiptohet dënim me burgim efektiv në kohëzgjatje prej 1 (një) vit, e 4 (katër) muaj, në këtë dënim koha e kaluar në paraburgim nga data 07.06.2023 e deri më datën 06.07.2023, do ti llogaritet në dënimin e shqiptuar me burgim. Ndërsa për të pandehurin L.U, është arritur marrëveshja të që t'i shqiptohet dënim me burgim ne kohëzgjatje prej 6 muaj, i cili dënim me pëlqimin e tij, zëvendësohet në dënim me gjobë prej 3,000 (tremijë) euro, koha e kaluar në arrest shtëpiak nga data 07.06.2023 e deri më datën 06.07.2023, do ti llogaritet në dënimin e shqiptuar me burgim.

Mbrojtësi i të pandehurit E.H.2, av.Fatmire Brahaj, ka deklaruar se: qëndrojmë edhe me tutje pranë marrëveshjes të arritur ne prokurori për pranimin e fajësisë dhe të njëjtin i propozojmë gjykatës që ta aprovon.

I pandehuri E.H.2 ka deklaruar se: e përkrahi në tërësi deklarin e mbrojtësit tim.

Mbrojtësi i të pandehurit L.U, av. Ridvan Kajtazi ka deklaruar se: qëndrojmë prapa marrëveshjes për pranimin e fajësisë të lidhur prokurori, e njoftojmë gjykate se i mbrojturi im fajësinë e ka pranuar pasi është konsultuar paraprakisht me mua, i njëjti ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit te fajësisë, andaj i propozoj gjykatës që këtë marrëveshje ta pranoj dhe të mbrojturit time ti shqiptoj dënimin me burgim prej 6 muaj, i cili me pëlqimin e të mbrojturit tim do t'i zëvendësohet me dënim me gjobe ne shume prej 3000 mijë euro.

I pandehuri L.U ka deklaruar se e përkrahi në tërësi deklarin e mbrojtësit tim.

Gjykata ka aprovuar marrëveshjet për pranim të fajësisë nën shenjën PP.I.nr.29/2023 të datës 06.07.2023 dhe 12.09.2023 për të pandehurit E.H.2 dhe L.U, pasi që të njëjtat janë përpiluar konform nenit 230 të KPPRK-së, në marrëveshje palët janë dakorduar që të pandehurit E.H.2 t'i shqiptohet dënim me burgim efektiv në kohëzgjatje prej 1 (një) vit, e 4 (katër) muaj, në këtë dënim koha e kaluar në paraburgim nga data 07.06.2023 e deri më datën 06.07.2023, do ti llogaritet në dënimin e shqiptuar me burgim. Ndërsa të pandehurit L.U, t'i shqiptohet dënim me burgim ne kohëzgjatje prej 6 muaj, i cili dënim me pëlqimin e tij, zëvendësohet në dënim me gjobë prej 3,000 (tremijë) euro, koha e kaluar në arrest shtëpiak nga data 07.06.2023 e deri më datën 06.07.2023, do ti llogaritet në dënimin e shqiptuar me burgim.

Pas deklarimit të pandehurve, mbrojtësve dhe prokurorit të shtetit lidhur me marrëveshjen për pranimit të fajësisë, për veprat penale si në hyrje të këtij dispozitivi, pasi që gjykata u bind se të akuzuarit e kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare, se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit, të pranuar nga të akuzuarit, pas konsultimit të mjaftueshëm me mbrojtësit e tyre dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike prandaj, gjykata e aprovoj pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarve ngase janë përmbushur kushtet për pranimitin e fajësisë bazuar në dispozitat ligjore të KPPRK-së.

Pas pranimit të fajësisë dhe konstatimit të përmbushjes se kushteve të parapara në nenin 242 të KPPRK-së, gjykata nuk është lëshuar në nxjerrjen dhe administrimin e provave të cilat kanë të bëjnë me vërtetimin e gjendjes faktike, se të pandehurit e kanë kryer veprat penale që i vihen në barrë, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Nisur nga pranimi i fajësisë, Gjukata ka ardhur në përfundim se në veprimet e të pandehurve formësohen të gjitha elementet qenësore objektive dhe subjektive të veprës penale në bashkëkryerje Falsifikimi i parasë nga neni 296 par.2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së dhe veprës penale ndihmë në kryerjen e veprës penale Falsifikimi i parasë nga neni 296 par.2 lidhur me nenin 33 të KPRK-së, për të cilat akuzohen. Andaj, gjykata të njëjtit i shpalli fajtor, pasi që gjeti se penalisht janë përgjegjës dhe i gjykoj si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Gjukata me rastin e matjes dhe përcaktimit të lartësisë dhe llojit të sanksionit penal për të akuzuarin, i vlerësoi të gjitha rrethanat relevante rënduese dhe lehtësuese, në kuptim të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së, andaj si rrethanë veçanërisht lehtësuese për të akuzuarit mori faktin se, të njëjtit kanë arritur marrëveshje për pranimitin e fajësisë në prokurori dhe kanë mbetur pranë saj edhe në gjykatë, derisa si rrethanë lehtësuese gjithashtu vlerësoi, se është hera e parë që kanë ra ndesh me ligjin, janë të gjendjes së dobët ekonomike, pendimin e thellë dhe shprehjen e keqardhjes para gjykatës për kryerjen e këtyre veprave penale, ndërsa si rrethanë rënduese ndaj të akuzuarve gjykata gjeti mënyrën si e kanë kryer veprën penale, shkallën e lartë të dashjes dhe se të njëjtit janë të moshës së re. Andaj gjykata duke i pasur parasysh të gjitha rrethanat e lartcekura dhe dispozitave nga neni 71 dhe 72 të KPRK-së, i shqiptoj dënim nën kufirin e paraparë me ligj dhe sanksionin penal përkatës si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me bindje se ky sanksion i tillë penal, është në përputhshmëri të plotë me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të këtyre veprave penale dhe përgjegjësisë penale të të akuzuarve dhe se dënimet e shqiptuara do të ndikojnë në riedukimin, risocializimin dhe parandalimin e të akuzuarve dhe personave tjerë nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, me çka edhe do të arrihet qëllimi i përgjithshëm dhe i veçantë i dënimit komfor nenit 38 të KPRK-së.

Gjukata në mbështetje të nenit 296, par.6 të KPRK-së dhe nenit 276, par.1 dhe par.2, pika 2.5 të KPPRK-së, ndaj të akuzuarit ka urdhëruar konfiskimin e përhershëm të bimëve të kanabisit, të cekura si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Vendimi lidhur me shpenzimet e procedurës penale kundër të akuzuarit, do të merret në bazë të llogarisë përfundimtare të kësaj gjykate, ndërkaq shpenzimet në emër të paushallit gjyqësor janë marrë konform nenit 449, par.3 të KPRK-së.

Vendimi lidhur taksën për programin e kompensimit të viktimave u mor konform nenit 39, par.3, pika.3.2 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit (Ligji nr. 05/L036).

Nga arsyet e cekura më lartë, e në pajtim me dispozitat ligjore nga neni 230 dhe 364 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINE
Departamenti për Krime të Rënda
PKR.nr.372/23, datë 22.03.2024

G j y q t a r i

Alban Ajvazi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve nga koha e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.